



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 1376/1 Prot.

Tiranë, më 17.07.2017

V E N D I M

Nr.165, datë 17/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 56, datë 16.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë".

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 56, datë 16.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë,"

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 12, datë 27.02.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 56, datë 16.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të inspektimit në lidhje me procesin e ristrukturimit, në institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, që do jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Për rregullimin e ligjshmërisë së procesit, njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit në mënyrë nominale për secilin nëpunës, sipas parashikimeve të nenit 50, pika 3, të Ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimit Nr. 171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i emërimit të çdo nëpunësi dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).

3. Akti i deklarimit të statusit për secilin nëpunës civil të administratës së Këshillit të Qarkut Gjirokastrër të formulohet në mënyrë nominale dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit (dosje individuale).
4. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim, të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).
5. Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të përpilohet sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe të nënshkruhen nga nëpunësi civil, eprori direkt i nëpunësit civil, si dhe nga titullari i institucionit (në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm dhe të Drejtorit të Përgjithshëm).
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të vendimit të mësipërm, Komisioneri me shkresën nr. 693/2 prot., datë 25.05.2017, “Kërkesë për plotësim dokumentacioni për zbatimin e Vendimit Nr. 56, datë 16.06.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka kërkuar informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e këtij vendimi dhe vënien në dispozicion të të gjithë praktikës shkresore që materializon zbatimin e tij.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Këshilli i Qarkut Gjirokastrër, me shkresat nr. 377/1 prot., datë 09.06.2017, “Përcjellje dokumentacioni” dhe nr. 377/2 prot., datë 12.07.2017, “Kthim përgjigje”, ka vënë në dijeni Komisionerin në lidhje me masat e marra, duke dërguar bashkëlidhur dokumentacionin që materializon zbatimin e këtij vendimi.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar në dosjen përkatëse të verifikimit, rezultoi se:

- Në përputhje me parashikimet e nenit 50, pika 3, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit në raportin përfundimtar të inspektimit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet nominale të emërimit si më poshtë:

1. Vendimin nr.19/5, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e inspektorit për mbrojtjen e tokës bujqësore për rrethet Gjirokastrër, Tepelenë, Përmet të nëpunëses *****
2. Vendimin nr.19/2, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për zbatueshmërinë ligjore të administratës në këshillin e qarkut, administratën e

ndërmarrjes së Rrugëve Rurale, për prokurimet dhe blerjet e vogla, të nëpunëses

3. Vendimin nr.19/4, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit në zbatim të ligjit për mbajtjen e llogarive kontabël, të nëpunëses *****
4. Vendimin nr.19/8, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për arkivin e urbanistikës (Projekti GIS) projektet për administratën dhe marrëdhëniet për projektet me njësitë e qeverisjes vendore të nëpunëses *****
5. Vendimin nr.19/10, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për marrëdhëniet me publikun, shoqatat joqeveritare dhe shtresat në nevojë të nëpunësit *****
6. Vendimin nr.19/6, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për projektet agrobiznes, turizëm, mjedis dhe marrëdhëniet ndërkufitare të nëpunëses *****
7. Vendimin nr.19/3, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për zbatimin e detyrave në përputhje me ligjin dhe udhëzimet për protokollin, arshivën, magazinën e shtypshkrimet të nëpunëses *****
8. Vendimin nr.19/9, datë 16.04.2015, për emërimin në detyrën e specialistit për infrastrukturën urbane dhe emergjencat civile të nëpunësit *****

Pavarësisht se aktet nominale të emërimit mbajnë një datë më të hershme se vendimi i Komisionerit, në momentin e kryerjes së inspektimit, grupit të inspektimit i është vënë në dispozicion vetëm urdhri kolektiv i emërimit nr. 3, datë 09.01.2015, “Për emërim në detyra funksionale”, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

- Në respektim të kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3,4 dhe 6, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit në mënyrë nominale, në përputhje me pikën 3 të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit, akte të cilat janë bërë pjesë e dosjeve individuale për nëpunësit e mëposhtëm:

1. Akti datë 16.06.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
2. Akti datë 16.06.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
3. Akti nr. 112/12 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
4. Akti nr. 112/7 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
5. Me aktin nr. 112/9 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
6. Me aktin nr. 112/10 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësin *****
7. Me aktin nr. 112/5 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
8. Me aktin nr. 112/27 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësen *****
9. Me aktin nr. 112/8 prot., datë 02.07.2014, “Deklarim i statusit të nëpunësit civil”, për nëpunësin *****

Pavarësisht se aktet nominale të deklarimit të statusit të punësimit mbajnë një datë më të hershme se vendimi i Komisionerit, në momentin e kryerjes së inspektimit, këto akte nuk janë vënë në dispozicion të grupit të inspektimit.

Bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësit ***** dhe ***** janë liruar nga shërbimi civil për shkak të plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie me urdhrat si më poshtë:

- Urdhri nr. 9, datë 27.01.2017, “Për Lirimin nga Shërbimi Civil”, të punonjësit *****.
- Urdhri nr. 12, datë 07.02.2017, “Për Lirimin nga Shërbimi Civil”, të punonjësit *****.

- Në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikës 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe në zbatim të pikës 4 të dispozitivit të vendimit, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, ka marrë mendimin me shkrim të të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit, nëpërmjet një deklaratë individuale, e më tej janë bërë pjesë e dosjes personale të nëpunësve.
- Në zbatim të pikës 5 të vendimit dhe të rekomandimeve të Komisionerit në Raportin Përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm rezultoi se nga ana e institucionit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, formati i përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, është përpiluar sipas lidhjes nr.4 bashkëlidhur Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave. Përshkrimet e punës janë nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt i nëpunësit civil, si dhe nga titullari i institucionit.

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe 34 të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 56 datë 16.06.2015 në institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 56 datë 16.06.2015, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë”.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA